



01.02.2024

Në mbështetje të nenit 108/A pika 3 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr.04/L-042, I ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237. Ligji Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenit 4 të Rregullave për parashtrimin e ankesave të miratuara nga KRPP, sipas Kërkesës për Rishqyrtim nga **OE NPT Haxhijaha shpk** me seli në Rahovec të datës: 30.01.2024, si palë e interesuar në procedurën e aktivitetit të prokurimit "**Furnizim me mekanizem bujqësor Lot.1- Multikultivator**" për miserme numër Prokurimit **634-23-1991-1-2-1**, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit/ZPP pas analizimit, ekzaminimit dhe shtjellimit të kërkesës për rishqyrtim me datën: 01.02.2024 nxjerr:

## VENDIM

I. **Hudhet e pabazuar** Kërkesa për Rishqyrtim të **OE NPT Haxhijaha shpk** me seli në Rahovec të datës: 30.01.2024 për aktivitetin e prokurimit "**Furnizim me mekanizem bujqësor Lot.1- Multikultivator**" me numër Prokurimit **634-23-1991-1-2-1** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- Komuna Kline.

## ARSYETIM

**Neni 1** – Në LPP 04/L-042, neni 1, paragrafi 1, mes tjerash thotë: " Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike". Mbi këtë bazë AK ka bërë vlerësimin, duke u bazuar në efikasitet, transparencë, integritet dhe kulturën institucionale pa anashkaluar asnjëherë atë që thuhet me lart si".....më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike.....". Pretendimi për shkelje të Nenit 1, nga ana e AK cilësohet **I PABAZUAR**.

**Neni 7**, Në LPP 04/L-042, neni 7, paragrafi 1&2, mes tjerash citon: "...Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. – Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që reduktkon apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik". AK gjatë vlerësimit ka vepruar në përputhje të plotë me rekomandimet e këtij Neni sepse ju ka dhënë mundësin e barabartë të gjithë OE mbi të gjitha AK ka vepruar në harmoni të plotë me Raportin e Expertit dhe Vendimin e dhënë nga Paneli Shqyrtues nga OSHP me Nr. 780/2023 i datës 11.01.2024. **Pretendimi për shkelje të Nenit 7, nga e AK cilësohet I PABAZUAR;**

**Neni 59** – Në LPP 04/L-042, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i tenderëve ndër të tjera citon: "4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të

përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigojnë pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundur, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Pra, AK dhe komisioni vlerësues ka vepruar conform këtij ligji duke bërë ekzaminim, vlerësim dhe krahasim të tenderëve bazuar në këtë Nen. Prandaj, pretendimi juaj ankimor edhe mbi këtë bazë ligjore është **I PABAZUAR**.

Për të tjera pika ankimore të listuara në 2, 3 dhe 4 sërish keni cekur pretendime aspak relevante dhe si të tilla të gjitha konsiderohen **plotësisht si të pabazuara**. Bajra NPT ka dërguar deklaratë liferimi për të gjitha Lotet në të cilat kanë ofertuar dhe me të cilën është zotuar që do të përmbush afatin kohor për liferim të pajisjeve sipas kërkesës së FDT-së. Forma e katalogut / broshurës nuk ndryshon materien apo të qenurit i përgjegjshëm apo JO përderisa cdo specifike e kërkuar është e paraqitur dhe dëshmuar mbi vërtetësin e tyre përkundër faktit

Bazuar në arsyet e lartëcekura dhe në bazë të Neni 115 të Ligjit të Prokurimi Publik në Kosovë dhe Rregullores së Prokurimit nr.001/2022, UA 001/2023 dhe Vendimit të OSHP 780/2023 Zyrtari Përgjegjës i Prokurimi ju njofton se **NUK PAJTOHET ME KËRKESËN TUAJ PËR RISHQYRTIM DHE SE VENDIMI I AK MBI DHENIE MBETET NË FUQI**.

AK-Komuna Kline ka përgatitur specifikimet teknike në harmoni me nevojat e veta dhe në përputhje me qëllimin e prokurimit.

### **Këshille Juridike**

**Kundër çdo vendimit të marrë nga AK-komuna Kline në përputhje me rrethanat e nenit 108/A, çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së në afat prej 10 ditësh nga data e pranimin të këtij vendimi.**

**Labinot Morina**

**ZYRTARI PËRGJEGJËS I PROKURIMIT**

### **Vendimi i dërgohet:**

- **OE NPT Haxhijaha shpk** (përmes E-Prokurimit).
- Zyrës së Prokurimit.

**Date: 01.02.24**